



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:210684

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766404

C.nr.1979/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.L. nga Prizreni, me numër personal të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve "Klinaku&..... me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e avansimit në karrierë dhe zhvillimit profesional, vlera e kontestit 6,159.54 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.L. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.
- II. **DETYROHET** e paditura, që paditësit, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 01.09.2018 deri më datë 06.02.2023 apo për 54 muaj (për çdo muaj shumën prej 89.03 euro, në shkallë prej 35% të pagës bazë 421.00 euro t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej **4,807.62 euro**, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- III. **REFUZOHET**, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumës së gjykuar sikurse në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 6,159.54 euro, përkatësisht në shumën prej 1,351.92 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri me datën 30.09.2018 apo për 16 muaj (për çdo muaj shumën prej 89.03 euro), **si e pa bazuar**.

- IV. **DETYROHET** e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Sh.L. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij Shoqëria e Avokatëve "Klinaku&..... me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate, me datën 21.09.2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e avansimit në karrierë dhe zhvillimit profesional.

Në padi, paditësi ka theksuar se është i punësuar si mësimdhënës pranë SH.F.M.U. "Gj.K.Skënderbeu" në fshatin Mazrek, Komuna e Prizrenit, me titull Master i Arteve në Trashëgimia Kulturore dhe Menaxhimi i Turizmit. Pasi që paditësi ka të kryer fakultetin e Edukimit, atij i është e garantuar pagesa shtesë prej 35% në pagën bazë dhe 10% të pagës bazë, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Tutje ka shtuar se paditësja realizon pagën bazë në shumën prej 421.00 euro, ndërsa pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e lartcekur, ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet që e paditura në kompensimin e këtij detyrimi ndaj paditësit, nga data 18.04.2017 deri më 22.01.2021 përkatësisht nga data 22.01.2021 e në vazhdim, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor deri në pagesën definitive dhe në kompensimin e shpenzimeve të procedurës.

Paditësi së fundmi me parashtrësën e datës 06.03.2024, përmes të autorizuarit të tij ka bërë precizimin e padisë ashtu që ka kërkuar që paditësit t'i njihet e drejta e kompensimit të pagës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, në shumë prej 89.03 euro për çdo muaj në pagën bazë prej 421.00 euro, nga data 18.04.2017 deri më 06.02.2023 për çdo muaj nga 89.03 euro, në shumën e përgjithshme prej 6,159.54 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç

pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate.. Gjithashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të kualifikimit për vitin 2017 dhe deri më 27.07.2021, është parashkruar, sepse sipas nenit 353 të LMD-së kjo e drejtë është parashkruar, andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, precizimit të datës 06.03.2024, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi Sh.L. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë SH.F.M.U. "Pjetër Mazreku" në fshatin Mazrek, Komuna e Prizrenit. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit si dhe nëse kërkesa e paditësit për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës me numër të protokollit 72/18, të datës 25.09.2018, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës. Paditësi ka diplomuar me datë 13.11.2019 dhe ka marr titullin profesional Master i Arteve në Trashëgimia Kulturore dhe Menaxhimi i Turizmit dhe ka licencë të karrierës. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *"shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që*

konfirmohet apo caktohet në të". Andaj, meqë këto dokumente, përkatësisht kontrata e punës, vërtetimi dhe lista e pagave janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që "nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimitdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit". Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se "mësimitdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). *Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%* dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%". Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që "për kërkesat e mësimitdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008", vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t'ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditëses ia ka paguar shumën prej 58.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro.

Në këtë drejtim, gjykata vendosi si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 89.03 euro, për periudhën kohore prej datës 01.09.2018 deri më datë 06.02.2023 apo për 54 muaj, shumën e përgjithshme prej 4,807.62 euro. Pra, diferenca e pa paguar çdo muaj shumën prej 89.03 euro, duke e shumëzuar 54 muaj ($54 \times 89.03 = 4,807.62$ euro).

Gjykata konstaton se me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 21.09.2021, në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.08.2019 e deri më 06.02.2023, edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 21.09.2021,

gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin shtator 2018 respektivisht nga data (01.09.2018) pasi që parashkrimi për kërkesën e paditësit për muajin shtator 2018 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që i njëjti ka pranuar pagën e muajit shtator 2018, e cila pagë realizohet në fund të muajit shtator 2018, rrjedhimisht i njëjti atëherë është njoftuar se e paditura nuk ka përmbushur detyrimin për kompensimin e kualifikimit për muajin shtator 2018 dhe nga fillimi i muajit vijues saktësisht 01 Shtator 2018, i njëjti ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimin, në bazë të nenit 342 të LMD-së, parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura gjykata konstaton se padia e paditësit për periudhën 01.09.2018 e deri më 06.02.2023, nuk është parashkruar pasi që nuk është arritur afati i paraparë me neni 87 të Ligjit të Punës.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 21.09.2021, ndërsa kërkesa e tij ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar sipas nenit 87 të LP-së për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data e kërkuar 18.04.2017 deri me datën 30.08.2018. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 16 muaj apo në shumën prej 1,424.48 euro (16x89.03=1,424.48 euro). Ndërsa me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 21.09.2021, në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.09.2018 e deri më 06.02.2023,

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. ka vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që *“kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritator me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritator.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 21.00 euro. Gjkata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, përkatësisht për precizimin e padisë meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1979/2021, me datë 31.05.2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.